



Manual Advokimi:

KOMUNIKIMI I AKSESUESHËM DREJT GJITHËPËRFSHIRJES

Manuali i Advokimit – Projekti ACTIVE

Rreth Manualit të Advokimit

Ky manual Advokimi është hartuar me qëllim mbështetjen e përpjekjeve drejt komunikimit të aksesueshëm dhe përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve të tjera që përballen me barriera sa i takon aksesit në informacion. Ai synon forcimin e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), organizatave të personave me aftësi të kufizuara (OPAK) dhe organizatave për ngritjen e kapaciteteve (ONK) për të advokuar për miratimin dhe zbatimin e standardeve të aksesueshmërisë në praktikat e komunikimit, politikat publike dhe dokumentet institucionale. Manuali ofron udhëzime praktike, mjete dhe shembuj për të ndihmuar aktorët lokalë për promovimin e komunikimit të aksesueshëm përmes ndërgjegjësisë, dialogut me institucionet dhe pjesëmarrjes aktive në proceset e vendimmarrjes.

Pse ka rëndësi Komunikimi i Aksesueshëm në Ballkanin Perëndimor

Në Ballkanin Perëndimor, shumë njerëz ende përballen me barriera të konsiderueshme në informim dhe komunikim. Institucionet publike shpesh publikojnë informacione në gjuhë komplekse ose teknike pa versione të përshtatura për njerëzit me nevoja të ndryshme komunikimi. Interpretimi në gjuhën e shenjave dhe titrat ende nuk ofrohen në mënyrë sistematike në evente publike ose materiale online. Faqet e internetit dhe platformat digjitale shpesh janë të paaksesueshme për përdoruesit e lexuesve të ekranit ose për njerëzit me shprehje të kufizuara digjitale. Për më tepër, zërat e lexuesve të ekranit nuk janë të disponueshëm në gjuhën shqipe, gjë që i privon personat e verbër shqiptarë nga e drejta për të përdorur plotësisht dhe pa barriera pajisjet elektronike përmes lexuesit të ekranit. Këto barriera kufizojnë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, njerëzve me nivel të ulët të shkrim-leximit dhe anëtarëve të komuniteteve minoritare në jetën shoqërore, kulturore dhe politike.

Ajo mbështet zbatimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe kontribuon në uljen e pabarazive sociale dhe ekonomike duke siguruar që informacioni të jetë i disponueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë.

Për këtë arsye, komunikimi i aksesueshëm nuk është thjesht një çështje teknike—është një çështje e të drejtave të njeriut dhe një parakusht për pjesëmarrje të barabartë, përfshirje dhe demokraci.

Çfarë është Advokimi?

Advokimi nënkupton ndërmarrjen e veprimeve të organizuara për të ndikuar në vendime, politika dhe praktika që prekin jetët e njerëzve.

Në kontekstin e komunikimit të aksesueshëm, advokimi përfshin bashkëpunimin me vendimmarrësit, institucionet, median dhe komunitetet për të siguruar që informacioni dhe komunikimi të jenë të kuptueshëm dhe të aksesueshëm për të gjithë.

Advokimi e tejkalon ndërgjegjësimin, i cili kryesisht informon dhe edukon. Ai gjithashtu dallon nga ofrimi i shërbimeve, i cili ofron mbështetje të drejtpërdrejtë për individët.

Advokimi fokusohet në ndryshimin e sistemeve dhe rregullave, në mënyrë që përfshirja të bëhet pjesë e përhershme e mënyrës se si funksionojnë institucionet.

Advokimi efektiv kombinon prova, komunikim strategjik, partneritete dhe këmbëngulje për të sjellë ndryshime. Ai kërkon qëllime të qarta, bashkëpunim të fortë mes organizatave dhe pjesëmarrje aktive të personave me aftësi të kufizuara—duke ndjekur parimin “Asgjë për ne, pa ne.”

Kujt i shërben ky manual?

Ky manual është hartuar për një gamë të gjerë aktorësh që kanë rol në promovimin e komunikimit të aksesueshëm, duke përfshirë:

- Organizatat për ngritje kapacitetesh
- Organizatat e shoqërisë civile të fokusuara në përfshirje dhe barazi
- Grupet e vetadvokimit dhe të drejtave të personave me aftësi të kufizuara
- Institucionet publike dhe ofruesit e shërbimeve në nivel lokal dhe kombëtar
- Vendimmarrësit dhe politikëbërësit nga autoritetet qendrore dhe lokale
- Aktorët e medias, teknologjisë së informacionit dhe arsimit që ndikojnë në mënyrën se si krijohen dhe shpërndahen informacionet

Si të përdoret ky manual

Ky manual është hartuar si një udhëzues praktik hap pas hapi, që organizatat mund ta përshtatin në kontekstin e tyre. Çdo pjesë e manualit mbështet një fazë të ndryshme të procesit të advokimit:

1. **Kuptimi i komunikimit të aksesueshëm** – Mësimi i koncepteve dhe parimeve kryesore që e bëjnë komunikimin gjithëpërfshirës.
2. **Udhëzuesi i Planifikimit të Advokimit** – Përcaktimi i qëllimeve, identifikimi i aktorëve të interesit dhe hartimi i një plani vendor advokimi.
3. **Mjetet për Angazhim dhe Ndikim** – aksesimi i modeleve, letrave dhe këshillave praktike të gatshme për ndërtimin e partneriteteve dhe organizimin e aktiviteteve.
4. **Materialet e Komunikimit** – gjetja e shembujve dhe udhëzimeve vizuale për krijimin e materialeve të aksesueshme për fushata.
5. **Burimet Ligjore dhe ato të Politikave** – të Kuptuarit e kuadrit ligjor që mbështet advokimin dhe mësimi i mënyrës së përdorimit të tij.
6. **Monitorimi dhe Vlerësimi** – ndjekja e progresit, matja e suksesit dhe nxjerrje mësimesh nga përvoja e advokimit.

Manuali mund të përdoret në seanca trajnimi, takime planifikimi ose gjatë përgatitjes së veprimeve lokale të advokimit. Ajo mund të shërbejë gjithashtu si manual referimi kur hartohen fushata ndërgjegjësimi, krijohen materiale të aksesueshme ose në angazhime me autoritetet publike.

1. Kuptimi i Komunikimit të Aksesueshëm

• Çfarë është komunikimi i aksesueshëm?

Komunikimi i aksesueshëm nënkupton krijimin dhe shpërndarjen e informacioneve në mënyrë që të gjithë ta kuptojnë dhe ta përdorin atë, pavarësisht aftësive, moshës, nivelit arsimor apo prejardhjes.

Ai përfshin shkrimin dhe dizenjimin e informacioneve në mënyrë të qartë, përmes përdorimit të gjuhës së thjeshtë/të kuptueshme, materialeve vizuale të aksesueshme dhe formateve digjitale gjithëpërfshirëse. Kjo përfshin materiale në gjuhë të thjeshtë ose të lehtë për t'u lexuar, përshkrime audio, titra, gjuhë shenjash dhe formate digjitale të përputhshme me lexuesit e ekranit.

- **Për personat me aftësi të kufizuar në dëgjim**, videot me interpretim në gjuhën e shenjave dhe me titra janë thelbësore për të siguruar akses të barabartë në informacione.

- **Për personat e verbër ose me shikim të dobët**, dokumentet duhet të përfshijnë tekst alternativ për imazhet, materiale vizuale të kontrolluara për kontrastin dhe formate të lexueshme nga teknologjitë ndihmëse.

Komunikimi i aksesueshëm siguron që askush të mos përjashtohet nga të kuptuarit apo pjesëmarrja për shkak të mënyrës se si paraqitet informacioni.

• Ku qëndron rëndësia?

Komunikimi i aksesueshëm ndihmon në uljen e pabarazisë dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke siguruar qasje të barabartë në informim dhe pjesëmarrje.

Ai mbështet zbatimin e **Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (UNKDPAK)**, veçanërisht nenet 9 dhe 21, të cilat garantojnë aksesueshmërinë dhe aksesin në informim.

Kur komunikimi është gjithëpërfshirës, komunitetet bëhen më të informuara, më të angazhuara dhe më të fuqizuara.

• Kush përfiton?

- **Personat me aftësi të kufizuara** (të shurdhër, të verbër, me shikim të pjesshëm, me vështirësi në dëgjim, persona me aftësi të kufizuara intelektuale)
- Personat me demencë ose sfida njohëse
- Personat me vështirësi në lexim ose të nxëniet
- Personat analfabetë ose ata me arsim të kufizuar
- Anëtarët e komuniteteve minoritare
- Personat me një gjuhë amtare tjetër
- Personat që përjetojnë stres, lodhje ose përqendrim të kufizuar

Llojet e Aksesueshmërisë në Komunikim

Komunikimi i aksesueshëm është i ndërlidhur me disa forma të aksesueshmërisë:

- **Aksesueshmëria fizike** – sigurimi që hapësirat ku shpërndahen informacionet (p.sh., takime, ngjarje, zyra) të jenë të aksesueshme për persona me vështirësi në lëvizshmëri ose me dëmtime fizike të tjera.
- **Aksesueshmëria digjitale** – sigurimi që faqet e internetit, aplikacionet, videot dhe dokumentet të përmbushin standardet e aksesueshmërisë (p.sh., të lexueshme nga lexuesit e ekranit, titrat e shtuara në video, formate të aksesueshme të dokumenteve).

- **Aksesueshmëria gjuhësore** – sigurimi që gjuha e përdorur të jetë e qartë, e kuptueshme dhe e përshtatshme kulturalisht (p.sh., gjuhë e lehtë për t'u lexuar, gjuhë e thjeshtë, përkthim në gjuhë minoritare ose lokale).
- **Aksesueshmëria shqisore** – sigurimi që informacioni të mund të merret përmes shqisave të ndryshme (shikim, dëgjim, prekje), për shembull përmes gjuhës së shenjave, përshkrimit audio ose materialeve në Braille.

Këto lloje të aksesueshmërisë shpesh mbivendosen—një event gjithëpërfshirës, për shembull, kërkon qasje fizike në vendin e zhvillimit, materiale të shtypura të aksesueshme, interpretim në gjuhën e shenjave dhe përmbajtje online që ndjek standardet e aksesueshmërisë digjitale.

Kuadri Ligjor dhe Politik

Komunikimi i aksesueshëm mbështetet nga disa kuadre ndërkombëtare dhe evropiane:

- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** – Nenet 9 dhe 21 garantojnë aksesueshmërinë dhe të drejtën për informim.
- **Direktiva e BE-së për Aksesueshmërinë e Uebit (2016/2102)** – kërkon që faqet e internetit dhe aplikacionet mobile të sektorit publik të jenë të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.
- **Akti Evropian për Aksesueshmërinë (2019/882)** – zgjeron kërkesat për aksesueshmëri në produkte dhe shërbime si kompjuterët, bankat dhe tregtia online.
- **Udhëzimet për Aksesueshmërinë e Përmbajtjes në Ueb (WCAG 2.1)** – standarde ndërkombëtare për ta bërë përmbajtjen digjitale të perceptueshme, të përdorshme, të kuptueshme dhe të qëndrueshme.
- **Standardi ISO 30071-1** – ofron udhëzime për integrimin e aksesueshmërisë në krijimin e produkteve digjitale.

Shembuj të komunikimit të aksesueshëm vs. jo të aksesueshëm

Komunikim Jo-Aksesueshëm	Komunikim I aksesueshëm
Një njoftim publik i shkruar me fjali të gjata, komplekse dhe plot zhargon administrativ.	Një njoftim i shkurtër, i qartë, i shkruar në gjuhë të thjeshtë, me informacionin kryesor (çfarë, ku, kur, kush) të paraqitur me pika.
Një video pa titra ose interpretim në gjuhën e shenjave.	Një video me titra, interpretim në gjuhën e shenjave dhe përshkrim të folur të elementeve vizuale.
Një dokument PDF i krijuar nga imazhe të skanuara që nuk mund të lexohen nga lexuesit e ekranit.	Një dokument PDF i strukturuar ose HTML me tituj të rregullt, tekst alternativ për imazhet dhe strukturë të lexueshme.
Një poster me tekst të vogël dhe kontrast të dobët ngjyrash.	Një poster me shkronja të mëdha, të lexueshme, kontrast të fortë ngjyrash dhe ikona të qarta.
Imazhe të shpërndara në rrjete sociale ose faqe interneti pa tekst alternativ.	Imazhe të shpërndara në rrjete sociale dhe faqe interneti që përfshijnë tekst alternativ (ALT text).

Shembuj të Praktikave të Mira

- **Ljubljana (Slloveni)** Në Slloveni, transmetuesi publik kombëtar **RTV Slovenija** ofron çdo ditë lajme me interpretim në gjuhën e shenjave, titra dhe formate në gjuhë të lehtë për t'u lexuar (ETR). Segmenti i lajmeve në gjuhë të lehtë **“Dostopno – novice v lahkem jeziku”** (“E aksesueshme – Lajme në gjuhë të lehtë”) krijohet në bashkëpunim me ekspertë dhe persona me aftësi të kufizuara intelektuale.
- **Austria – Kanali ORF TV** Në Austri, transmetuesi publik kombëtar prodhon dhe transmeton rregullisht programe lajmesh në gjuhë të lehtë për t'u lexuar (ETR). Segmentet e thjeshtuara të lajmeve janë të dizenuara për persona me aftësi të kufizuara intelektuale, të moshuar dhe të tjerë që mund ta kenë të vështirë ndjekjen e formateve standarde të lajmeve.
- **Bashkia e Novi Sadit, Serbi – Informacione për Shërbime në Gjuhën e Shenjave** Qyteti i Novi Sadit ka prezantuar një nismë pionere për t'i bërë informacionet e bashkisë të aksesueshme për qytetarët me aftësi të kufizuara në dëgjim. Në faqen

zyrtare të qytetit dhe kanalin e tij në YouTube, njoftimet publike dhe informacionet për shërbimet — si përditësimet mbi eventet lokale, shërbimet bashkiake dhe njoftimet emergjente — prezantohen rregullisht në gjuhën serbe të shenjave, krahas versioneve të folura dhe të shkruara.

- **Bashkia e Sarajevës, Bosnje dhe Hercegovinë – Udhëzuesi “Meet Sarajevo” i Aksesueshëm dhe Gjithëpërfshirës** Projekti **“Meet Sarajevo – Accessible & Inclusive Visitor Guide”** ofron informacion turistik dhe fletëpalosje për Sarajevën në gjuhë të lehtë për t’u lexuar, në gjuhë të thjeshtë, në mënyrë që personat me aftësi të kufizuara dhe të huajt të kenë mundësi ta aksesojnë dhe ta shijojnë qytetin.

2. Udhëzuesi për Planifikimin e Advokimit

Çfarë është Planifikimi i Advokimit?

Planifikimi i advokimit është procesi i përcaktimit të ndryshimit që dëshironi të arrini, mënyrës se si do ta arrini dhe kë duhet të influenconi.

Një plan advokimi i ndihmon organizatat që të veprojnë në mënyrë strategjike, të përdorin burimet në mënyrë efikase dhe të masin rezultatet. Në promovimin e komunikimit të aksesueshëm, një plan i mirë bën dallimin midis një aktiviteti të njehershëm dhe një ndryshimi afatgjatë në sjelljen ose politikat institucionale.

- **Përcaktimi i Qëllimit të Advokimit**

Një qëllim i fortë advokimi duhet të jetë **specifik, i matshëm, i arritshëm, realist dhe i kufizuar në kohë (SMART)**.

Shembuj:

- Të influencohet Bashkia X për të miratuar një politikë lokale mbi komunikimin e aksesueshëm deri në dhjetor 2026.”
- Të sigurohet që të gjitha fletëpalosjet e informacioneve bashkiake të jenë të disponueshme në Gjuhë të Lehtë për t’u Lexuar dhe në gjuhën e shenjave deri në mesin e vitit 2025.”

Pyetje që duhet t’i bëhen vetes:

- Çfarë ndryshimi specifik duam të shohim?
- Kush e ka pushtetin për ta bërë këtë ndryshim?
- Si do të duket suksesi dhe si do ta dimë që e kemi arritur?

Qëllimet e qarta dhe realiste ndihmojnë në ruajtjen e fokusit dhe besueshmërisë gjatë gjithë fushatës.

- **Të kuptuarit e Çështjes dhe Identifikimi i Aktorëve**

Fillohet duke analizuar situatën aktuale:

- Cilat janë barrierat për komunikimin e aksesueshëm në komunitetin ose institucionin tuaj?
- A ekzistojnë ligje, strategji ose udhëzime që mbështesin aksesueshmërinë, por ende nuk janë zbatuar?
- Cilat janë nevojat e personave të prekur nga komunikimi i paaksesueshëm?

Më pas, identifikoni aktorët kryesorë: personat, grupet ose institucionet që mund të ndihmojnë ose të pengojnë përpjekjet tuaja të advokimit.

Aktorët mund të përfshijnë:

- Autoritetet lokale dhe kombëtare
- Organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK) dhe organizatat e shoqërisë civile
- Shoqatat e personave me aftësi të kufizuara në dëgjim dhe grupet e përdoruesve të gjuhës së shenjave
- Media dhe gazetarët
- Institucionet arsimore dhe të teknologjisë së informacionit
- Bizneset që ofrojnë shërbime komunikimi ose digjitale

Gjithmonë të zbatohet parimi **“Asgjë për ne, pa ne.”** Personat me aftësi të kufizuara duhet të luajnë rol aktiv në çdo fazë të advokimit: që nga planifikimi dhe vendimmarrja deri te përfaqësimi publik.

• Hapat për hartimin e një Plani Lokal Advokimi

- **Qëllimi:** Çfarë ndryshimi specifik dëshirohet të arrihet?
 - **Kërkimi dhe Analiza:** Mbledhje informacionesh mbi çështjen dhe aktorët kryesorë.
 - **Objektivat:** Hapa konkretë që çojnë drejt arritjes së qëllimit.
 - **Mesazhet Kryesore:** Çfarë doni të thoni dhe si ta shprehni qartë?
 - **Audienca e Synuar:** Kush ka pushtetin për të bërë ndryshimin?
 - **Aktivitetet:** Veprimet për të arritur qëllimin (mbledhje, fushata, evente, dalje në media).
 - **Afati Kohor:** Kur do të zhvillohet secili aktivitet?
 - **Burimet dhe Buxheti:** Çfarë burimesh njerëzore dhe financiare nevojiten?
 - **Monitorimi dhe Vlerësimi:** Si do të ndiqet progresi dhe suksesi?
-
- **Hartimi i Mesazheve Efektive të Advokimit**

Mesazhi është ura që lidh qëllimin me audiencën. Për të qenë bindës, mesazhet e advokimit duhet të jenë:

- **Të qarta dhe të thjeshta** – një ide kryesore për çdo mesazh.
- **Të bazuara në prova** – të mbështetura nga fakte, të dhëna dhe përvoja të jetuara.
- **Emocionalisht angazhuese** – të përfshijnë histori reale dhe perspektiva njerëzore.
- **Të orientuara drejt zgjidhjes** – jo vetëm të përshkruajnë problemet, por të propozojnë veprime realiste.
- **Të përshtatura për audiencën** – të përdorin gjuhë dhe argumente që lidhen me prioritetet e vendimmarrësve (p.sh., efikasiteti, drejtësia, përfitimi për komunitetin).

Shembull:

✗ “Personat me aftësi të kufizuara përballen me barriera në komunikim.”

✓ “Duke përdorur gjuhë të thjeshtë dhe interpretim në gjuhën e shenjave, bashkia juaj mund të sigurojë që çdo qytetar të kuptojë informacionin publik — dhe të forcojë besimin tek institucionet lokale.”

- **Menaxhimi i Rreziqeve dhe Parashikimi i Sfidave**

Advokimi shpesh përfshin sfida të tilla si: financim i kufizuar, mungesë vullneti politik ose keqkuptim i konceptit të aksesueshmërisë.

Për të pakësuar rreziqet:

- **Identifikoni pengesat e mundshme herët** (p.sh., procedurat burokratike të ngadalta, ndryshimet në drejtim).
- **Përgatitni veprime ose aleatë alternativë** nëse partnerët kryesorë nuk janë të disponueshëm.
- **Mbani komunikim konstruktiv** edhe me palët e interesuara që fillimisht kundërshtojnë ndryshimin.
- **Dokumentoni progresin** —provat e shkruara ndihmojnë në ruajtjen e vrullit të avokimit edhe kur ka ndryshime në drejtim.

Model plani advokimi

Plani i Advokimit: Komunikimi i Aksesueshëm

Qëllimi

- Të arrihet një ndryshim sistemik që siguron që komunikimi të jetë i aksesueshëm për të gjithë, pavarësisht aftësisë, gjuhës ose mediumit.
- **Shembull:** “Të detyrohen të gjitha institucionet publike të ofrojnë informacion në gjuhë të thjeshtë, me interpretim në gjuhën e shenjave dhe në formate digjitale të përputhshme me teknologjitë ndihmëse.”

Kërkimi dhe Analiza

- Vlerësoni barrierat aktuale në komunikim (p.sh., faqet e internetit të paaksesueshme, mungesa e titrave, dokumente të mbushura me zhargon).
- Identifikoni aktorët kryesorë: agjencitë qeveritare, organizatat për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, kompanitë e teknologjisë, institucionet arsimore dhe komunitetet e prekura.
- Mblidhni prova mbi ndikimin e komunikimit të paaksesueshëm (shërbime të humbura, përjashtim, pabarazi).

Objektivat

Hartimi i hapave të matshëm drejt aksesueshmërisë

- **Advokoni për legjislacion** që kërkon formate të aksesueshme.
- **Trajnoni stafin** në praktikat e komunikimit gjithëpërfshirës.
- **Partneritet me ofruesit e teknologjisë** për të përmirësuar mjetet e aksesueshmërisë.
- **Nisni fushata ndërgjegjësimi** mbi rëndësinë e komunikimit të aksesueshëm.

Mesazhet Kryesore

- Mesazhi bazë: “Komunikimi është një e drejtë, jo një privilegj.”
- Theksoni se nga aksesueshmëria përfitojnë të gjithë (informacione më të qarta, shtrirje më e gjerë, përfshirje më e fortë).
- Përshtatni mesazhet sipas audiencës:
 - Për vendimmarrësit: përputhshmëri ligjore.
 - Për bizneset: rritje e klientëve.
 - Për komunitetet: fuqizim dhe pjesëmarrje e barabartë.

Audienca e Synuar

- **Primare:** vendimmarrësit, agjencitë e shërbimeve publike, drejtuesit e korporatave në teknologji dhe media.
- **Sekondare:** institucionet arsimore, ofruesit e shërbimeve shëndetësore, gazetarët dhe publiku i gjerë që mund të amplifikojë kauzën.

Aktivitetet

- Organizoni mbledhje me zyrtarë qeveritarë për të shtyrë përpara standardet e aksesueshmërisë.
- Zhvilloni fushata që nxjerrin në pah historitë e personave të përjashtuar nga komunikimi jo-aksesues.
- Mbani workshop-e mbi gjuhën e thjeshtë, titrat dhe dizenjën gjithëpërfshirëse.
- Bashkëpunoni me mediat për të promovuar praktikën e komunikimit të aksesueshëm.
- Përdorni rrjetet sociale për të modeluar aksesueshmërinë (tekst alternativ, titra, postime në gjuhë të thjeshtë).

Afati Kohor

- **Muajt 1–2:** Kërkim dhe ndërtim koalicioni.
- **Muajt 3–4:** Nisja e fushatës së ndërgjegjësimit.
- **Muajt 5–6:** Advokim politik dhe takime me aktorët kyç.

- **Muajt 7–8:** Programet e trajnimit dhe projektet pilot.
- **Vazhdimisht:** Monitorim dhe vlerësim.

Burimet dhe Buxheti

- **Burime njerëzore:** ekspertë të aksesueshmërisë, trajnerë, advokues, vullnetarë.
- **Burime financiare:** materiale fushatash, shpenzime për aktivitete, shërbime aksesueshmërie (interpretë, titra, përkthim).
- **Partneritete:** OJQ-të, universitetet, kompanitë e teknologjisë.

Monitorimi dhe Vlerësimi

Treguesit:

- Numri i institucioneve që miratojnë politika për komunikim të aksesueshëm.
- Shtimi i materialeve të aksesueshme (video me titra, dokumente në gjuhë të thjeshtë, burime shumëgjuhëshe).
- Komentet dhe reagimet nga komunitetet që përballen me barriera në komunikim.

Veprimet:

- Rishikoni rregullisht progresin.
- Përshtatni strategjitë sipas rezultateve dhe feedback-ut.

3. Mjetet për Angazhim dhe Ndikim

Advokimi efektiv varet nga fakti se sa mirë komunikoni, bashkëpunoni dhe mobilizoni të tjerët. Ky seksion ofron mjete praktike për t'ju ndihmuar të angazhoheni me institucionet, të ndërtoni partneritete dhe të rrisni ndërgjegjësimin për komunikimin e aksesueshëm.

Modele për Letra dhe Email-e

Komunikimi i shkruar me institucionet publike duhet të jetë gjithmonë formal, i shkurtër dhe i drejtpërdrejtë. Një letër e strukturuar mirë rrit mundësinë për të marrë një përgjigje të shpejtë dhe pozitive.

Shembull Model Letrës (për t'u shtuar në aneksin me modele)

Subjekti: Kërkesë për një takim mbi Komunikimin e Aksesueshëm

I nderuar [Titulli dhe Emri],

Ne po ju shkruajmë në emër të [Emri i Organizatës], një organizatë që punon për të promovuar komunikimin e aksesueshëm dhe aksesin e barabartë në informacion për të gjithë qytetarët.

Do të vlerësojmë mundësinë për t'u takuar me ju, për të diskutuar mënyrat se si [Emri i Institucionit] mund të kontribuojë në përmirësimin e aksesueshmërisë në komunikimin publik, në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Besojmë se bashkëpunimi midis institucioneve publike dhe shoqërisë civile mund të sjellë zgjidhje praktike dhe gjithëpërfshirëse që përfitojnë të gjithë anëtarët e komunitetit.

Ju lutemi të na njoftoni për një datë dhe orar të përshtatshëm për këtë takim.

Me respekt, [Emri, Pozicioni] [Organizata] [Email / Telefon]

Këshillë:

- Mbajeni kërkesën specifike dhe të respektueshme.
- Nëse nuk ka përgjigje pas dy javësh, dërgoni një kujtesë të sjellshme.
- Gjithmonë falënderoni institucionet për kohën ose përpjekjen e tyre, edhe nëse nuk arrihet një marrëveshje.

Organizimi i Tryezave të Diskutimit dhe Aktiviteteve Publike

Tryezat e rrumbullakëta dhe diskutimet publike janë mundësi të fuqishme për të paraqitur mesazhet kryesore, për të lidhur aktorët e interesuar dhe për të ndërtuar aleanca për komunikimin e aksesueshëm.

Hapat për Organizimin e një Aktiviteti të Suksesshëm:

1. Përcaktoni qëllimin: Çfarë rezultati prisni (ndërgjegjësim, angazhim, bashkëpunim)?
2. Përzgjidhni pjesëmarrësit: Përfshini organizatat e personave me aftësi të kufizuara (OPAK), autoritetet lokale, OJQ-të, median dhe partnerët ndërkombëtarë.
3. Zgjidhni një vend të aksesueshëm: Siguroni akses fizik, ndriçim të mirë, cilësi të zërit dhe hapësirë për përkthyes.

4. Përgatitni agjendën: Përfshini prezantime të shkurtra, diskutim të hapur dhe një përmbledhje të qartë të konkluzioneve.
5. Siguroni aksesueshmërinë: Ofroni interpretim në gjuhën e shenjave, titra dhe materiale të lehta për t'u lexuar (Easy-to-Read).
6. Ndihni: Dërgoni një përmbledhje të konkluzioneve, foto ose një njoftim për shtyp pas aktivitetit.

Lista udhëzuese për Aksesueshmërinë në Aktivitetet Publike

- Vendi ka hyrje pa shkallë dhe tualete të aksesueshme.
- Sistemi i zërit dhe mikrofonët janë të disponueshëm.
- Ofrimi i interpretimit në gjuhën e shenjave.
- Titra ose transkriptim i drejtpërdrejtë për videot.
- Materialet e shtypura në format të Lehtë për t'u Lexuar (Easy-to-Read) dhe në format digjital.
- Transporti dhe parkimi janë të aksesueshëm.

Ndërtimi i Koalicioneve dhe Partneriteteve

Advokimi është më i fuqishëm kur bëhet së bashku. Formimi i koalicioneve u lejon organizatave të bashkojnë ekspertizën dhe të arrijnë një audiencë më të gjerë.

Hapat për të Ndërtuar ose për t'iu Bashkuar një Koalicioni:

1. Identifikoni partnerët potencialë – OPAK, OJQ, media, aktorë të arsimit dhe teknologjisë së informacionit, si dhe bizneset gjithëpërfshirëse.
2. Organizoni një mbledhje fillestare koordinimi për të përcaktuar qëllimet e përbashkëta.
3. Rënia dakord për ndarjen e përgjegjësisë (p.sh., një partner menaxhon median, një tjetër merret me kontaktet në komunitet).
4. Formalizoni bashkëpunimin përmes një Memorandumi Mirëkuptimi (MoU).

Koalicionet gjithashtu mund të koordinojnë fushata të përbashkëta ose propozime politike, të cilat kanë më shumë dukshmëri dhe legjitimitet kur mbështeten nga disa organizata.

Mobilizimi i Komunitetit dhe Përdorimi i Mediave

Mobilizimi i komunitetit ndihmon në ndërtimin e mbështetjes publike dhe siguron që aksesueshmëria të shihet si përgjegjësi e të gjithëve. Angazhoni qytetarët dhe median lokale duke ndarë histori pozitive, reale dhe shembuj të përfshirjes.

Këshilla për Bashkëpunim me Median:

- Dërgoni njoftime për shtyp të shkurtra (1 faqe) me një titull të qartë, një citim dhe një person kontakti.
- Ofrojeni gazetarëve një histori njerëzore ose dëshmi (p.sh., si informacioni i aksesueshëm i ka ndryshuar jetën dikujt).
- Organizoni konferenca të vogla për shtyp ose ftoni gazetarët në aktivitete publike.
- Siguroni materiale vizuale – foto, infografikë ose video të shkurtra që e bëjnë aksesueshmërinë konkrete dhe frymëzuese.

Advokimi Digjital dhe Fushatat Online

Mjetet digjitale e bëjnë më të lehtë arritjen e një audience të gjerë dhe mobilizimin e mbështetjes në mënyrë të shpejtë. Përdorni rrjetet sociale dhe faqet e internetit për të rritur ndërgjegjësimin, për të promovuar histori suksesi dhe për të bërë thirrje për veprim.

Këshilla Praktike për Advokimin Digjital:

- Krijoni mesazhe dhe materiale vizuale të shkurtra e të aksesueshme për rrjetet sociale (përdorni hashtag si #KomunikimIAksesueshëm ose #PërfshirjePërTëGjithë).
- Postoni video me titra dhe interpretim në gjuhën e shenjave.
- Ndani dëshmi nga persona me aftësi të kufizuara, por vetëm me pëlqim të informuar dhe respekt për dinjitetin.
- Përdorni mjete falas dhe të aksesueshme për dizeno (p.sh., Canva) dhe sigurohuni për kontrast të lartë ngjyrash dhe fonte të lexueshme.
- Nxisni angazhimin përmes sondazheve, historive ose zotimeve online.
- Merrni në konsideratë peticione online ose letra të hapura për të kërkuar ndryshim politikash.

Tregimi Etik i Historive

Kur përdorni përvoja të jetuara, gjithmonë:

- Merrni pëlqimin e qartë nga personi i përfshirë.
- Shmangni paraqitjen e individëve si “përfitues” pasivë.
- Theksoni fuqizimin dhe autonominë, jo mëshirën.
- Lejoni që njerëzit të flasin me zërin e tyre sa herë që është e mundur.

Komunikimi me Vendimmarrësit

- Angazhimi me vendimmarrësit kërkon përgatitje, profesionalizëm dhe këmbëngulje. Takimet e advokimit janë më të suksesshme kur janë të fokusuara dhe të respektueshme.

Këshilla për Komunikim Efektiv:

- Hulumtoni institucionin dhe prioritetet e tij aktuale para takimit.
- Përgatitni një shënim informues të shkurtër ose një përmbledhje 1-faqëshe të propozimit tuaj.
- Filloni bisedën me interesa ose vlera të përbashkëta (p.sh., përfshirje sociale, transparencë).
- Përdorni fakte dhe shembuj, jo vetëm opinione.
- Kërkoni një hap të qartë vijues (p.sh., “A mund t’ju dërgojmë një draft propozimi politik javën e ardhshme?”).
- Gjithmonë ndiqni pas me një email falënderimi të shkurtër që përmbledh diskutimin dhe veprimet e dakorduara.

Mbani mend: advokimi është një dialog afatgjatë, jo një takim i vetëm. Ndërtimi i besimit me institucionet rrit mundësinë për ndryshime të qëndrueshme.

4. Materialet e Komunikimit

Materialet e komunikimit të qarta, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse janë thelbësore për përhapjen e mesazheve kryesore dhe frymëzimin e veprimit. Ky seksion ofron udhëzime praktike për përgatitjen e materialeve të fushatave që janë të lehta për t'u kuptuar, vizualisht gjithëpërfshirëse dhe të aksesueshme për të gjithë.

Mesazhe dhe Slogane Shembull

Kur disenjoni fushata ndërgjegjësimi, zgjidhni mesazhe të shkurtra, të paharrueshme dhe pozitive që theksojnë përfshirjen dhe aksesueshmërinë.

Shembuj:

- Një mesazh, i aksesueshëm për të gjithë.
- Përfshirja fillon me komunikimin.
- Gjuha e thjeshtë – e drejta për t'u informuar.
- Të kuptuarit është përfshirje.
- Informacion i aksesueshëm, shoqëri gjithëpërfshirëse.
- Komunikim pa barriera.

Këshillë

Mbajini sloganet nën 8 fjalë, përdorni folje veprimi kur është e mundur dhe shmangni termat teknikë.

Modele Vizuale dhe Shembuj

Materialet tuaja vizuale — postera, broshura dhe postime në rrjetet sociale — duhet të pasqyrojnë të njëjtat parime të aksesueshmërisë si përmbajtja e shkruar.

Parime Kryesore për Materialet Vizuale:

- **Thjeshtësi dhe qartësi:** përdorni dizajn minimalist me mesazhe të dukshme.
- **Kontrast i lartë ngjyrash:** sigurohuni që tekstet të lexohen lehtë.
- **Fontet e lexueshme:** shmangni stilet dekorative që vështirësojnë leximin.
- **Vizuale gjithëpërfshirëse:** përdorni foto dhe ilustrime që pasqyrojnë diversitetin dhe përfshirjen.
- **Aksesueshmëri digjitale:** sigurohuni që posterat dhe broshurat të jenë të disponueshme edhe në format elektronik.

Modele Vizuale dhe Shembuj

Materialet tuaja vizuale — postera, broshura dhe postime në rrjetet sociale — duhet të pasqyrojnë të njëjtat parime të aksesueshmërisë si përmbajtja e shkruar.

Udhëzimet për dizenjon

- Përdorni skema të thjeshta me hapësirë të bollshme bosh.
- Zgjidhni kombinime ngjyrash me kontrast të lartë (p.sh., tekst i errët mbi sfond të hapur).
- Përdorni fonte sans-serif si Arial, Calibri ose Helvetica; minimumi 14 pt për materialet e shtypura dhe 18 pt për prezantimet.
- Shmangni vendosjen e tekstit mbi imazhe ose sfondet me motive.
- Përfshini një kod QR ose një link të shkurtër për versionin online ose të Lehtë për t'u Lexuar (Easy-to-Read).
- Përdorni ikona dhe ilustrime për të mbështetur idetë kryesore, jo thjesht për dekorim.
- Gjithmonë shtoni tekst alternativ (alt text)

Shembuj Konceptesh

- **Poster:** Një vizual i thjeshtë me njerëz të ndryshëm që komunikojnë, me një slogan të shkurtër dhe një kod QR.
- **Postim në Rrjetet Sociale:** Një mesazh i shkurtër (“Gjuha e thjeshtë është fuqi”) mbi një sfond të pastër, me logon e projektit dhe linkun.
- **Broshurë:** Me tituj të qartë, ikona dhe pika kryesore që përmbledhin mesazhin kryesor.

Përgatitja e Materialeve në Gjuhë të Thjeshtë

Gjuha e thjeshtë e bën komunikimin të kuptueshëm për sa më shumë njerëz. Kur krijoni materiale, ndiqni këto rregulla kryesore:

- Përdorni fjali të shkurtra (jo më shumë se 15 fjalë).
- Përdorni fjalë të njohura; shmangni metaforat dhe idiomat.

- Shkruani në formën veprorë (“Ju ftojmë” në vend të “ftoheni”).
- Paraqisni një ide për paragraf.
- Përdorni tituj dhe pika për të organizuar informacionin.
- Përdorni fonte të mëdha dhe të lexueshme, me hapësirë të qartë.
- Mbështetni tekstin me imazhe ose piktograma që shpjegojnë, jo që shpërqendrojnë.
- Kombinoni formatet: Gjuhë e Thjeshtë + Titra + Gjuhë e Shenjave = akses i plotë.

● Testimi i Aksesueshmërisë

Para se të publikoni ose shpërndani materiale, testojini ato për aksesueshmëri. Përfshini përdorues realë dhe kërkonit reagime të sinqerta.

Hapat e Thjeshtë për Testim:

1. Reagimi i Përdoruesve: Kërkoni që 3–5 persona me nevoja të ndryshme komunikimi (të shurdhër, të verbër, persona të moshuar, përdorues teksti të Lehtë për t’u Lexuar) të shqyrtojnë draftin.
2. Kontrolli i Kuptueshmërisë: Pyetni, “Për çfarë është ky material?”
3. Kontrolli me Lexues Ekrani: Përdorni mjete falas si NVDA (Windows), JAWS ose VoiceOver (Mac/iPhone) për të testuar dokumentet digjitale.
4. Kontrasti i Ngjyrave: Kontrolloni vizualet me mjete si Contrast Checker (WebAIM), Colour Contrast Analyser ose Coolers.co Contrast Tool.

✓ **Këshillë: Bëjeni testimin pjesë të procesit tuaj të punës, jo një mendim të vonuar. Aksesueshmëria përmirësohet me përsëritje dhe reagime.**

Mjete dhe Burime Falas

Mund të krijoni dhe testoni materiale të aksesueshme duke përdorur mjete me burim të hapur ose falas:

Qëllimi	Mjetet / Lidhjet e Rekomanduara
Dizajn vizualesh të aksesueshme	www.Canva.com https://piktochart.com/?nab=0

Testimi i kontrastit të ngjyrave	Colour Contrast Analyser
Testimi me lexues ekrani	NVDA, JAWS
Gjuhë e thjeshtë dhe lexueshmëri	
Biblioteka fotosh falas: https://www.pexels.com/ https://unsplash.com/	

Aksesueshmëria Shumëgjuhëshe dhe në Gjuhët Lokale


Komunikimi i aksesueshëm nënkupton edhe përfshirje gjuhësore. Në rajonet shumëgjuhëshe, sigurohuni që materialet të jenë të disponueshme në gjuhët që fliten nga komuniteti juaj.

Këshilla Praktike:

- Përktheni materialet kryesore të fushatës në gjuhët e pakicave dhe në gjuhën e shenjave.
- Përdorni shembuj të thjeshtë dhe kulturalisht të përshtatshëm gjatë përkthimit.
- Përfshini kode QR dygjuhëshe ose titra kur shpërndani video.
- Kur burimet janë të kufizuara, jepni përparësi të paktën versioneve në Gjuhë të Thjeshtë (Easy Language) për kuptim më të gjerë.

Aksesueshmëria shumëgjuhëshe jo vetëm që nxit kuptimin, por edhe ndërton besim dhe përfshirje mes grupeve të ndryshme.

Mbani mend: Aksesueshmëria nuk është një hap shtesë — ajo është themeli i komunikimit të mirë.



5. Burime Ligjore dhe Politike

- Përmbledhje e dokumenteve kryesore:

Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK). KDPAK është traktati kryesor ndërkombëtar që garanton të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Dy nene janë veçanërisht të rëndësishme për komunikimin:

- Neni 9 (Aksesueshmëria) kërkon që shtetet të mundësojnë akses në informacion, komunikim dhe shërbime.
- Neni 21 (Liria e shprehjes dhe akses në informacion) kërkon që shtetet të sigurojnë akses në informacion në formate të aksesueshme dhe të promovojnë gjuhët e shenjave dhe mediat e aksesueshme (p.sh. interpretim në gjuhën e shenjave, titra, braille). Këto nene mund të përdoren si argumente ligjore bazë kur kërkohet nga institucionet që informacioni publik të jetë i aksesueshëm.

Direktiva e BE-së për Aksesueshmërinë e Uebit (Direktiva (BE) 2016/2102). Kjo direktivë detyron organet e sektorit publik në BE të bëjnë faqet e tyre të internetit dhe

aplikacionet mobile të aksesueshme dhe të publikojnë një deklaratë mbi aksesueshmërinë. Direktiva i referohet standardeve teknike (si EN 301 549 / WCAG) që organet publike duhet të ndjekin. Edhe pse Kosova nuk është anëtare e BE-së, këto standarde përdoren gjerësisht si praktikë e mirë dhe mund të referohen në advokimin lokal.

Akti Evropian për Aksesueshmërinë (Direktiva 2019/882 / “EAA”). Ky akt vendos rregulla të harmonizuara për aksesueshmërinë e disa produkteve dhe shërbimeve (përfshirë disa shërbime digjitale) në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Ai ngre nivelin e aksesueshmërisë në tregun e brendshëm dhe është një referencë e rëndësishme për advokimin për kërkesa të harmonizuara për aksesueshmëri në rajon. Përdorimi i EAA tregon se detyrimet për aksesueshmëri po njihen gjithnjë e më shumë në ligj dhe politika në Evropë.

Standardet dhe Udhëzimet (WCAG, EN 301 549, ISO 30071-1). Standardet teknike e përkthejnë detyrimin ligjor në kërkesa konkrete për faqet e internetit, dokumentet dhe multimedian. Udhëzimet për Përmbajtjen e Aksesueshme në Ueb (WCAG) (aktualisht versionet 2.1/2.2) janë udhëzuesi kryesor ndërkombëtar për përmbajtjen digjitale. EN 301 549 është një standard evropian që harmonizon kërkesat teknike; ISO 30071-1 ofron udhëzime për integrimin e aksesueshmërisë në ofrimin e shërbimeve digjitale. Këtyre mund t’u referoheni kur kërkohet nga ekipet e IT-së ose furnitorët të marrin masa specifike.

Kornizat kombëtare: Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

- **Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”,** konkretisht neni 5, paragrafi 2, pika f; neni 19; neni 20.
- **Vendimi nr. 1074, datë 23.12.2015 i Këshillit të Ministrave “Për Eliminimin e pengesave në Infrastrukturë dhe Komunikim për Personat me Aftësi të Kufizuara”.**
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021–2025, ku për herë të parë në një dokument politik u përfshi një plan për aksesueshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.**

Pikat e Hyrjes për Advokim — ku dhe si të ndikohet politika

Pikat praktike të hyrjes për shoqërinë civile për të ndikuar në hartimin dhe zbatimin e politikave:

1. **Konsultimet publike** — përgjigjuni strategjive, ligjeve dhe rregulloreve bashkiake në fazë drafti me paraqitje të shkurtra, të bazuara në prova, duke iu referuar KDPAK dhe strategjisë kombëtare.
2. **Kuvendet lokale dhe mbledhjet e këshillave** — kërkoni hapësira në rendin e ditës për të paraqitur propozime për komunikim të aksesueshëm dhe klauzola model.
3. **Grupet e punës parlamentare ose qeveritare** — identifikoni komisionet përkatëse (çështje sociale, arsim, çështje digjitale) dhe ofroni kontribut teknik ose shembuj pilot.
4. **Proceset e prokurimit** — bëni thirrje për përfshirjen e kërkesave për aksesueshmëri në prokurimet publike (p.sh. shërbime komunikimi, faqe interneti, prodhues videosh).
5. **Dialogjet / tryezat e politikave** — organizoni ose bashkohuni në takime shumëpalëshe me OPAK, zyrtarë bashkiakë dhe ekipe IT për të ndërtuar konsensus dhe një plan zbatimi hap pas hapi.
6. **Media dhe fushatat publike** — përdorni prova dhe histori personale për të krijuar presion dhe për të treguar mbështetje publike për ndryshime konkrete.

Shembuj Rajonalë dhe të BE-së që mund të citohen (përdoren si referenca të praktikave më të mira)

- **Rastet e Çmimit Access City (qytete të BE-së si Ljubljana)** — tregojnë masa konkrete komunale si informacion i lehtë për t'u lexuar, shërbime në gjuhën e shenjave dhe nëpunës të emëruar për aksesueshmëri. Këto shembuj funksionojnë mirë kur advokohet në nivel bashkiak.
- **Akti Evropian për Aksesueshmërinë (EAA)** — përdorni dispozitat e EAA për të treguar se BE po ecën drejt aksesueshmërisë ligjërish të detyrueshme për shërbimet dhe produktet, një trend që politikat rajonale duhet ta ndjekin.
- **Ljubljana (Slloveni)** — qyteti i shpërblyer me Çmimin Access City për zbatimin e komunikimit bashkiak të aksesueshëm, informacionit të lehtë për t'u lexuar dhe njoftimeve publike shumëgjuhëshe.

- **Radiotelevizioni Publik i Serbisë (RTS)** — zgjerimi i programeve të lajmeve ditore me gjuhë të shenjave dhe titra, duke treguar se si përfshirja në media mund të evoluojë përmes udhëzimeve politike dhe presionit advokues.
- **Kroacia: Fushata për Turizmin dhe Kulturën e Aksesueshme** — parqet kombëtare dhe muzetë kroatë zbatuan sisteme informacioni të aksesueshme, përfshirë video me gjuhë të shenjave dhe titra si dhe materiale për vizitorët të lehta për t'u lexuar.
- **Strategjia e Kosovës** — referencë e rëndësishme për zhvillimin e politikave kombëtare mbi aksesueshmërinë.
- **Vjena** — shembull i një qyteti evropian që ka integruar aksesueshmërinë në shërbimet publike dhe komunikimin bashkiak.

6. Monitorimi dhe Vlerësimi

Për të matur suksesin e fushatës së advokimit: përdorni indikatorë specifikë si numri i institucioneve që kanë miratuar ndryshime konkrete. Për shembull, objektivi është që **70% e organizatave që marrin pjesë në trajnim** të bëjnë të paktën dy ndryshime në punën e tyre. Vlerësimi duhet të jetë i vazhdueshëm, duke përfshirë si të dhëna **sasore** (numra) ashtu edhe **cilësore** (komente, intervista).

Indikatorët dhe mjetet për monitorim:

- **Numri i institucioneve** që kanë miratuar një politikë/rregullore mbi komunikimin e aksesueshëm.
- **Numri i personave në nevojë** që raportojnë se kanë marrë informacion të aksesueshëm.
- **Numri i mediave** që kanë mbuluar fushatën.
- **Përdorimi i mjeteve të vlerësimit:** anketa, intervista, grupe fokusi dhe analiza e përmbajtjes mediatike.
- **Numri i dokumenteve** të publikuara edhe në gjuhën e shenjave.
- **Numri i aktiviteteve publike** ku është ofruar interpretim në gjuhën e shenjave.
- **Numri i videove** të prodhuara me interpretim në gjuhën e shenjave.

Tabela e Monitorimit dhe Vlerësimit të Aktiviteve të Advokimit	Objektivat specifike	Indikatori i suksesit (Si do ta masim?)	Rezultati i vlerësimit (Çfarë arritëm?)	Komente/Sfidat	Hapat e ardhshëm
Takimi me Bashkinë [emri]	Të sigurohet që politika për komunikim të aksesueshëm të përfshihet në planin vjetor të punës.	Marrëveshje e shkruar nga Bashkia për përfshirjen.	Bashkia ka shprehur gatishmëri, por kërkon një draft propozimi.	Mungesë informacioni teknik nga stafi bashkiak.	Hartimi i një propozimi konkret për rregulloren dhe dërgimi i tij në Bashki.
Fushata online “Gjuha e Lehtë”	Të rritet ndërgjegjësimi i publikut dhe institucioneve për rëndësinë e Gjuhës së Lehtë.	Numri i ndjekësve, pëlqimeve dhe shpërndarjeve të postimeve. Numri i mediave që mbuluan fushatën.	5,000 ndjekës të rinj; 1,200 pëlqime; 2 media lokale e mbuluan temën.	Angazhim i ulët nga vendimmarrësit online.	Organizimi i një konference për shtyp me gazetarë dhe zyrtarë qeveritarë.
Prezantimi i Manualit për OJQ-të	Të mundësohet që organizatat partnere të përdorin manualin për fushatat e tyre.	Numri i OJQ-ve që morën pjesë në trajnim. Feedback pozitiv nga pjesëmarrësit.	15 OJQ morën pjesë. Feedback-u ishte kryesisht pozitiv, veçanërisht për modelet e letrave.	Disa OJQ kërkuar më shumë shembuj nga praktika.	Krijimi i një grupi online për ndarjen e përvojave dhe shembujve.
Lobimi për përfshirjen e klauzolës	Të ndikohet një institucion publik që të miratojë klauzolën e propozuar në rregulloret e brendshme.	Miratimi zyrtar i rregulloreve të brendshme me klauzolën avokuese.	Rregullorja është në proces shqyrtimi, klauzola është përfshirë në draft.	Procesi i shqyrtimit është i ngadalshëm.	Nënshkrimi i një memorandumi mirëkuptim i me institucionin për të përshpejtuar procesin.

Fjalorthi

- **Aksesueshmëria (Accessibility)** Praktika e projektimit të mjediseve, produkteve, shërbimeve dhe informacionit në mënyrë që njerëzit me të gjitha aftësitë — përfshirë ata me aftësi të kufizuara — të mund t'i përdorin dhe të përfitojnë prej tyre pa barriera.
- **OPAK (Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara / DPO)** Organizata përfaqësuese të udhëhequra, drejtura dhe të administruara nga persona me aftësi të kufizuara. Qëllimi i tyre është të avokojnë për të drejtat, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në shoqëri, duke siguruar që zëri i tyre të jetë qendror në vendimmarrje.
- **Gjuha e Thjeshtë (Plain Language)** Komunikim i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i lehtë për t'u kuptuar. Shmang zhargonin dhe strukturat komplekse, në mënyrë që lexuesit ose dëgjuesit ta rrokin shpejt dhe saktë kuptimin.
- **Advokimi**

Veprimi i mbështetjes, promovimit ose argumentimit për një kauzë, politikë ose grup. Në kontekstin e aftësisë së kufizuar, advokimi shpesh nënkupton mbrojtjen e të drejtave, ndikimin në politika dhe garantimin e mundësive të barabarta.

- **Përfshirja**

Praktika e sigurimit aktiv që të gjithë individët, pavarësisht aftësisë, prejardhjes ose identitetit, të jenë të mirëpritur, të vlerësuar dhe të aftë të marrin pjesë plotësisht në shoqëri, arsim, punë dhe jetën komunitare.

Këto terma shpesh janë të ndërlidhur: **aksesueshmëria** e bën të mundur përfshirjen, **OPAK** udhëheqin përpjekjet e advokimit, ndërsa **gjuha e thjeshtë** siguron komunikim të barabartë.

Lista udhëzuese për Komunikim të Aksesueshëm (Fushata Advokimi)

Gjuha & Mesazhet

- Përdorni gjuhë të thjeshtë (fjali të shkurtra, fjalë të përditshme, shmangni zhargonin).
- Siguroni formate të lehta për t'u lexuar (shkrim i madh, përmbledhje të thjeshtuara).
- Ofroni përkthime në gjuhët lokale dhe në gjuhën e shenjave.
- Siguroni ndjeshmëri kulturore në formulim dhe në përdorimin e imazheve.

Formatet & Materialet

- Ofroni informacion në formate të shumta: tekst, audio, video, braille dhe versione të lehta për t'u lexuar.
- Përdorni tekst alternativ (alt text) për të gjitha imazhet dhe grafikat.
- Vendosni titra dhe/ose ofroni transkripte për të gjitha videot dhe regjistrimet audio.
- Siguroni që dokumentet të jenë miqësore për lexuesit e ekranit (me tituj të strukturuar, PDF të etiketuar, pa tekst vetëm të skanuar).

Aksesueshmëria Digjitale (Digital Accessibility)

- Ndiqui udhëzimet WCAG për faqet e internetit dhe përmbajtjen online.
- Siguroni navigim me tastierë (pa funksione vetëm me miun).
- Shmangni vizualet me shkëlqim ose pulsime që mund të shkaktojnë kriza epileptike.
- Ofroni dizajne me kontrast të përshtatshëm (tekst i errët mbi sfond të hapur, paleta ngjyrash të aksesueshme).

Komunikimi Ndërpersonal

- Ofroni interpretë të gjuhës së shenjave në evente dhe mbledhje.
- Siguroni pajisje ndihmëse për dëgjim ose titrim në kohë reale.
- Lejoni më shumë kohë për përgjigje dhe pyetje.
- Trajtoni stafin/vullnetarët mbi etikën e aftësisë së kufizuar (gjuhë respektuese, përdorim i aksesit “personi i pari” ose “identiteti i pari” sipas preferencës).

Shtrirja & Angazhimi

- **Përdorni kanale të shumta** (rrjete sociale, radio, qendra komunitare, fletushka të shtypura).
- **Siguroni postime të aksesueshme në rrjete sociale** (alt text, titra, hashtags në CamelCase si #AccessForAll).
- **Ofroni opsione kontakti përtej telefonit** (email, SMS, shërbime telefonike të aksesueshme për persona me aftësi të kufizuara në dëgjim).
- **Ftoni feedback nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK/DPO)** për të verifikuar nivelin e aksesueshmërisë.

✓ Kjo listë udhëzuese siguron që komunikimi në fushatat e advokimit të jetë gjithëpërfshirës, pa barriera dhe të respektojë nevojat e ndryshme.

Paketë për Fushata Advokimi të Aksesueshme

- **Përdorni kanale të shumta** (rrjete sociale, radio, qendra komunitare, fletushka të shtypura).
- **Siguroi postime të aksesueshme në rrjete sociale** (alt text, titra, hashtags në CamelCase si #AccessForAll).
- **Ofroni opsione kontakti përtej telefonit** (email, SMS, shërbime telefonike për persona me aftësi të kufizuara në dëgjim).
- **Ftoni feedback nga Organizatat e Personave me Aftësi të Kufizuara (OPAK/DPO)** për të verifikuar nivelin e aksesueshmërisë.

Logjistika e Aksesueshme

Aksesueshmëria e Vendit

- Hyrje pa shkallë, me rampë dhe ashensorë
- Tualete të aksesueshme dhe opsione neutrale gjinore
- Sinjalistikë e qartë me shkrim të madh dhe braille
- Hapësira të qeta për pjesëmarrësit neurodiversë

Transporti & Lëvizshmëria

- Ofroni opsione transporti të aksesueshme (furgonë për karroca, informacione mbi transportin publik)
- Ndani udhëzime të qarta me harta në formate të aksesueshme
- Ofroni stipendiume ose rimbursime udhëtimi për pjesëmarrësit me aftësi të kufizuara

Organizimi i eventit

- Organizoni ndenjëset me hapësirë për karroca dhe kafshë shërbimi.
- Siguroi që skena/podiumi të jetë i aksesueshëm.
- Ofroni ndriçim dhe sisteme zëri të rregullueshme.
- Testoni pajisjet ndihmëse përpara ngjarjes.

Përgatitja për Emergjencë

- Rrugë evakuimi të aksesueshme.

- Staf i trajnuar për përgjigje emergjente gjithëpërfshirëse ndaj aftësisë së kufizuar.
- Alarme vizuale dhe auditive të qarta.

Shtrirja e Aksesueshme

Mesazhe Gjithëpërfshirëse

- Përdorni përfaqësim të larmishëm në vizualet e fushatës
- Shmangni stereotipet; theksoni fuqizimin dhe autonominë
- Siguroni materiale të fushatës në gjuhë të shumta

Kanale & Platforma

- Shpërndani informacion në rrjete sociale të aksesueshme (alt text, titra, hashtags në CamelCase)
- Bashkëpunoni me radion komunitare, gazetatat lokale dhe rrjetet e aftësisë së kufizuar ose Përdorni SMS dhe email për ata me akses të kufizuar në internet

Angazhim & Feedback

- Bashkëpunoni me OPAK/DPO për të bashkëdizenuar strategjitë e shtrirjes
- Ofroni opsione të shumta feedback-u (anketa në formate të aksesueshme, telefon, email, ballë për ballë)
- Ndiqni të dhënat e pjesëmarrjes për të siguruar përfshirje në të gjitha grupet e aftësisë së kufizuar

Ndjekja pas Fushatës (Follow-Up)

- Shpërndani rezultatet e fushatës në formate të aksesueshme
- Njihni publikisht kontributet e pjesëmarrësve me aftësi të kufizuara
- Mbani komunikim të vazhdueshëm përtej fushatës

Burime Kryesore dhe Lexime të Mëtejshme

Ja një listë e hollësishme me burime kryesore dhe lexime të mëtejshme mbi aksesueshmërinë, advokimin dhe komunikimin gjithëpërfshirës nga OKB, BE, OJQ-të dhe ekspertët e dizenjës. Këto janë pikënisje të shkëlqyera për të thelluar mjetet tuaja të fushatës.

Organizata e Kombeve të Bashkuara & organizmat Globalë

- [UN Disability-Inclusive Communications Guidelines \(2021\)](#) **Udhëzimet e OKB-së për Komunikim Gjithëpërfshirës mbi Aftësinë e Kufizuar (2021)** — Udhëzime praktike për krijimin e përmbajtjes së aksesueshme, me lista kontrolli dhe shembuj.
- [UNICEF Accessibility Toolkit – Advocacy for Accessibility](#) **Toolkit i UNICEF për Aksesueshmërinë – Advokim për Aksesueshmëri** — Strategji për integrimin e aksesueshmërisë në projekte zhvillimi dhe humanitare.
- [UN Digital Accessibility Awareness Campaign](#) **Fushata e OKB-së për Ndërgjegjësimin mbi Aksesueshmërinë Digjitale** — Një nismë e gjerë e OKB-së që promovon aksesueshmërinë digjitale në të gjitha operacionet.

Bashkimi Evropian

- [European Accessibility Act \(EAA\)](#) - **Akti Evropian për Aksesueshmërinë (EAA)** — Direktivë që përcakton standarde të aksesueshmërisë në nivel BE-je për produkte dhe shërbime.
- [European Accessibility Act Toolkit for Transposition \(EUD\)](#) - **Toolkit i Aktit Evropian për Aksesueshmërinë për Transpozim (EUD)** — Udhëzues për zbatimin në nivel kombëtar.
- [European Accessibility Act Checklist for Communication](#) - **Lista udhëzuese e Aktit Evropian për Aksesueshmërinë për Komunikim** — listë udhëzuese praktike për komunikim dhe marketing gjithëpërfshirës.

OJQ-të & Shoqëria Civile

- [UNICEF Accessibility Advocacy Resources](#) **Burimet e UNICEF për Advokimin mbi Aksesueshmërinë** — Strategji advokimi të fokusuara tek OJQ-të.
- [Albanian Disability Rights Foundation \(ADRF\)](#) - **Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF)** — Shembull i nismave të advokimit dhe aksesueshmërisë të udhëhequra nga OJQ-të

- [National Resource Centre for Civil Society \(Albania\)](#) - **Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile (Shqipëri)** — Burime për shoqërinë civile, përfshirë mjete për aksesueshmëri.

Udhëzues për dizenjo të Aksesueshme

- [Accessible Design Principles & Heuristics Guide \(Level Access\)](#) - **Parimet e dizenjoes së Aksesueshme & Udhëzuesi orientues (Level Access)** — Mbi 170 rregulla orientuese për dizenjo digjitale të aksesueshme.
- [Venngage Accessible Design Tips + Examples](#) - **Këshilla & Shembuj për Dizajn të Aksesueshëm (Venngage)** — Këshilla praktike për komunikim vizual të aksesueshëm.

Si të Përdoren Këto Burime

- **Për fushatat e komunikimit:** Filloni me *Udhëzimet e OKB-së për Komunikim Gjithëpërfshirës mbi Aftësinë e Kufizuar* dhe listen udhëzuese të *Aktit Evropian për Aksesueshmërinë*.
- **Për logjistikën & shtrirjen:** Përdorni toolkit-in e *UNICEF* dhe shembujt e advokimit nga *ADRF*.
- **Për punën e dizenjoes:** Zbatoni rregullat orientuese nga *Level Access* dhe *Venngage* për të siguruar materiale vizualisht gjithëpërfshirëse.

✓ Aneks me template – formular plani advokimi, hartë e aktorëve, checklist për evente, template për email, shembuj për komunikata për media.

✓ Listë e shkurtër me kontakte ose rrjete relevante për komunikim të aksesueshëm (OPAK/DPO, shoqata të gjuhës së shenjave, ekspertë të aksesueshmërisë).